



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 24, datë 27.01.2020

PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Lazër Çardaku**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Z. Lazër Çardaku do të ushtrojë detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, përkohësisht nga data 27.01.2020-26.04.2020.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Z. Çardaku do të paguhet me pagën e pozicionit të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
4. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Z. Lazër Çardaku, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SELTI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR
BESNIK GANI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

